“Panairi i ushqimit “ Nën moton -Ushqimi gjëja që na bashkon të gjithëve.	Tetor	Drejtore Mësimdhënëse Nxënëse	Drejtore Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëse Nxënëse Prind Qytetar	Argëtimi i nxënësve

seksioneve, derisa në ditare të punës të paraleleve pjesë e aktiviteteve jashtë-mësimore do të insistojmë që mos i përfshijmë dhe eidentojmë formalisht.

Gjatë këtij viti shkollorë do të organizohen aktivitetet në vijim:

“Ora e hapur” Ku mësimdhënësit nga kl. I-V Prezantojn tema të ndryshme Në bazë të plan programit mësimor	Nëntor	Mësimdhënëës Nxënës	Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëës Nxënës Prind	Socializimi i nxënësve mes tyre
“28- Nëntori” Dita e flamurit kombëtar shqipëtar,në këtë ditë organizohet manifestim ,ku nxënësit performojn nëpërmet valleve,kore,recitime etj	Nëntor	Drejtore Mësimdhënëës Nxënës	Drejtore Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëës ,Nxënës Prind	Festimi i ditës se flamurit,
Aksioni humanitar “Nxënësi dhuron për nxënësin” Ku nxënësit dhurijn veshmbathje,mjete ushqimore, të cilat pastaj u dhurohen familjeve me status të rrezikuar social.	Dhjetor	Drejtore Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëës Nxënës	Drejtore Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëës Nxënës	Solidarizimi I nxënësve mes tyre
Ditë e vecant nga Arsimi Qytetar tema të ndryshme “Paragjikimet”Për përmirsim te komunikimit në mes nxënësve,mbahet puntorija mes nxënësve te klasave VIII-IX mbi paragjikimet	Dhjetor	Mësimdhënëës të Arsimit Qytetar	Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëës Nxënës	Përmirsimi i raporteve mes nxënësve
Memorandum–organizimin takimi me shkollën fillore “Strasho Pinxhur”-Kavadar		Drejtore Shërbimi pedagogjik	Drejtore Mësimdhënëës	Bashkpunim mes shkollave-shkëmbim idesh.

Vëllazrimi i shkollave bazuar në projektin e financuar nga MASH për bashkpunim më të mirë ndëretnik.	Dhjetor	Mësimdhënës Nxënës	Nxënës	
Aktivitete Ekologjike “Eko Aksioni” Organizim për pastrimin e rrugëve kryesore të vendit ton dhe mbjellja e fidaneve sipas IOM projektit .	Shkurt	Drejtor Mësimdhënës Nxënës	Mësimdhënës Nxënës	Pastrim i fshatit – kujdesje për ambientin
Vizitë parlamentare të RMV Nga ana e nxënësve të klasave të IX-ta	Shkurt	Drejtor	Drejtor Mësimdhënës Nxënës	Të njihen nxënësit me organin udhëheqës të vendit ton
Organizimi ” Orës së hapur” Nga mësimdhënësit e ciklit të lartë duke përdorur TIK-un	Mars	Mësimdhënës Nxënës	Shërbimi pedagogjik Mësimdhënës Nxënës	Të njihen nxënësit me mjetet elektronike.
“ 7-Marsi dita e Mësuesit”	Mars	Mësimdhënës	Drejtor Shërbimi pedagogjik Mësimdhënës	Festimi i kësaj feste madhështore.

“Kreativitete” Aktivitetet e ndryshme artistike nga ana e nxënësve të ciklit të ulët ku do të paraqiten punime arti si: piktura, skulptura, vizatime me tush dhe argjil.	Mars	Mësimdhënës Nxënës	Shërbimi pedagogjik Mësimdhënës Nxënës	Motivimi i nxënësve për vepra artistike
“ Projekte” Organizimi i projekteve të ndryshme si: vendosja nëpër mure të koridoreve ,tabelareve të ndryshme me thënje dhe punime të ndryshme të nxënësve.	Mars	Drejtor	Drejtor Mësimdhënës Nxënës	Ambientë më i bukur brenda dhe jashtë shkollës
“8 Marsi dita e Nënave “ Organizime të ndryshme ,punime ,vjersha ,këngë kushtuar nënave.	Mars	Mësimdhënës Nxënës	Mësimdhënës Nxënës Prind	Festimi i ditës së Gruas
Festivali I” Valleve dhe lojërave popullore “ Organizimi i valleve të ndryshme lojërave midis nxënësve të shollës tonë”Naïm Frashëri “dhe shkollës së Kavadarit “StrashoPinxhur”	Maj	Drejtor Mësimdhënës Nxënës	Drejtor Shërbimi pedagogjik Mësimdhënës Nxënës (Nga të dy shkollat)	Socializimi i nxënësve mes shkollave

“25 –Maji Patronati i shkollës”i titulluar “Ditët e Naimit” Fjalim nga ana e drejtorit të shkollës rreth historikut të saj,dhënja e lëvdatave të nxënësve për aritjet e tyre në gara të ndryshme brenda shkolle në gara komunale dhe më gjeër, dhe u realizuan këto aktivitete: Garat Sportive –Futboll,Volejboll ,Shah,Ping pong Kuiz diturije –Matematikë Aktivitetet e ciklit të ulët Drana –gjuhë Shqipe Panairi i shkencave Ekspozit	Maj	Drejtore Mesimdhëse Nxënëse	Drejtor Shërbimi pedagogjik Mësimdhënëse Nxënëse Prind	Festimi i ditës së Patronatit të shkollës
---	-----	---	---	---

SPORTI SHKOLLOR

Bashkëpunimi ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve; përfshirja në numër të madh proektesh nga lëmia e kulturës, arsimit dhe sportit e rrit efikasitetin e punës edukativo-arsimore në shkollën tonë. Veçmas kujdesje i bëhet procesit edukativo-arsimor të nxënësve dhe për popullaritetin e sportit shkollor. Ky është pjesë përbërse në jetën e përditëshme të nxënësve.

Shkolla jonë dhe këtë vit do të përgadit program dhe do të ja përshtas kalendarit të garave marr nga Federata shkollore e sporteve të Maqedonisë së Veriut dhe komuna e Vrapçishtit. Me fillimin e vitit shkollor në muajin shtator do formohen seksione sportive shkollore;

**Seksioni i volejbollit*

**Seksioni i basketboll*

**Seksioni I futbollit*

**Seksioni i ping pong*

**Seksioni i shahut*

Arsimtarët përgjegjës të seksionit të Arsimit Fizik dhe Shëndetësor janë: Rizvan Asani, Venhar Velija dhe Blerim Selmani

Për seksionet e lartëpërmendura arsimtarët përgjegjës përgadisin program për punë dhe caktojnë termine për ushtrime. Për të gjithë nxënësit sportist do të përgadisin libreza sportive dhe vizita mjeksore sportive (mjekësia sportive). Gjithashtu të gjithë nxënësit sportist detyrimisht do të jenë të siguruar. Përveç procesit ushtrues kolegët e sportistëve të rinj do t'u organizojnë mësim teorik edukativ.

Gjatë vitit shkollor nxënësve do t'u organizojmë:

*Shëtitje në rrethinën e afërt;

*Shëtitje në mal ku nxënësit do të njoftohen me bukuritë natyrore të Sharrit.

*Kros pranveror dhe vjeshtor në atletik.

SEKSIONE DHE AKTIVITETE TË LIRA TË NXËNËSVE

Aktivitetet të lira të nxënësve

-Aktivitetet nga lëmia e artit dhe kulturës.

Aktivitetet e lira nga lëmia e artit dhe kulturës do të paraqiten nëpërmjet: Aktiviteteve letrare, recituese, artistike, muzikore (mësim lëndor) këngë dhe folklorike (mësim klasor).

Aktivitete të lira për zgjerimin e njohurive të disa lëndë të veçuara:

Seksioni letrar dhe recitues-Seksioni letrar ka për qëllim që t'u mundëson nxënësve të talentuar t'i shprehin aftësitë e tyre krijuese në poezi, prozë dhe në gjinitë tjera letrare. Seksioni letrar organizon lexim letrar, përgadit gazeta të murit, dhe krijimet e tyre i paraqesin në gazetën e shkollës ku dhe do të shfaqen aftësitë e tyre krijuese në lëmin e gazetarisë. Realizator të programës së seksionit janë arsimtarët e gjuhës shqipe.

Sahide Ebibi, Shasine Ragibi dhe Behije Jonuzi

Seksioni i matematikantëve dhe fizikantëve të rinj- Ky seksion punon me program të vet, mund të miren parasysh çfardo përmbajtje nga Programi i rregullt vjetor për punë të shkollës fillore të vitit shkollor 2023/24 mësim nga matematika dhe fizika, nëse çmohet se me përmbajtjet e tilla do të zgjerohen njohuritë e nxënësve. Realizues të Programit të seksionit janë arsimtarët e matematikës dhe fizikës. Relizatorë: **Mijasere Selmani Vjollca Dervishi dhe Yllzana Hamza**.

Historianët e rinj-Ky seksion punon me program të vet dhe ka për qëllim që të thellëson njohuritë nga e kaluara historike e vendit tonë. Realizues: **Blerta Amiri dhe Ibrahim Ibrahim**

Seksioni biologjisë-ekologjisë- shkenca natyrore- Ky seksion aktivitetet e veta i programon dhe realizon nëpërmjet temave teorive, punëve praktike dhe nëpërmjet formave të tjera të punës. Qëllimi i këtij seksioni është përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor dhe në atë kuptim dhe programimi i aktiviteteve për të njëjtën funksion. Realizues: **Salije Mexhiti dhe Mirlida Vejseli**

Seksioni i gjeografisë-Ky seksion aktivitetet e veta i programon dhe i realizon nëpërmjet: Temave teorike, punëve praktike dhe në forma tjera të punës. Realizator: **Isen Demiri dhe Blerta Amiri**

Seksioni i gjuhëtarëve të rinj-Ky seksion ka për qëllim që të thellon njohuritë nga lëmia e gjuhëve të huaja dhe të krijohet interes dhe dashuri në mësimin e gjuhëve të huaja. Realizator janë arsimtarët: **Florije Bilalli dhe Zana Dalipi**.

Aktivitetet e lira kulturo-artistike

Seksioni i muzikës-Seksioni i muzikës do realizon pjesë të rëndësishme nga jeta kulturo-artistike në shkollë. Realizimi i programit të seksionit të muzikës do jetë nëpërmjet aktivitetit të korit të shkollës, solo-këngëtarëve, duetëve, grupeve kënduese, vallëzimit modern dhe të ngjashme. Seksioni i muzikës me paraqitjen e vet do çfaqet në raste të ndryshme siç është dita e patronatit të shkollës, dita e arsimit, mbarimi i vitit shkollor dhe të ngjashme. Realizator: **Ganimete Ilasi, Nehat Ibrahim dhe Sherif Mustafa**.

Seksioni i artit figurativ-Interesimi për artin figurativ do vij në shprehje në programin e artit figurativ. Për nxënësit që tregojnë interesim dhe afinitet për artin figurativ do ju ndihmohet që të perfeksionojnë talentin e tyre. Prezentimi do jetë nëpërmjet organizimit të ekspozitave dhe prezenteve të tjera. Realizator: **Verim Zendeli dhe Mirsad Osmani**

Aktivitetet sportive-Programi për aktivitetet sportive do të realizohet në pajtim me kushtet e sportimit. Prej aktiviteteve do të realizohen seksionet në vijim: I futbollit, basketbollit, Volejbollit, shah, ping pong dhe atletikës. Aktivitetet e lira të shprehura nëpërmjet sportit dhe artit kanë rëndësi shumë të madhe për shkak kushteve specifike të punës së shkollës. Me anë të aktivitetit fizike dhe me ate edhe prej ngjarjeve sportive, duhet që të plotësojnë atë shprehëti, këtu duhet që të këmbëngulet që të vjen një bashkëpunim i madh me mjedisin lokal, gjersa shkolla duhet të jetë bartëse e jetës kulturore. Në programet e këtyre seksioneve vend të rëndësishëm duhet të gjej funksioni edukativ, humaniteti dhe përforcimi i patriotizmit të ri. Realizator arsimtarët e edukatës fizike dhe të arsimit shëndetësor

GARAT E NXËNËSVE

Garat e nxënësve në shkollën tonë kanë rëndësi parësore, sepse para së gjithash duam që nxënësit tonë të arrijnë dituri që vijnë në shprehje kur ata garojnë me nxënës tjerë të shkollave tjera. Garat e nxënësve përfshijnë aktivitete nëpërmjet së cilave nxënësit i paraqesin të arriturat e tyre në mësim dhe në lëmi tjera të veprimtarisë edukativo-arsimore dhe e përfaqësojnë shkollën në mjedisin e vet lokal, qytetin, Republikën, por edhe në nivel ndërkombëtar. Këtu duhet të theksojmë seksionin e matematikanëve dhe pas krijimit të biznes-planit me të cilën edhe shkolla jonë ka arritur rezultate të lakmueshme.

Arsimtarët gjatë tërë vitit shkollorë në vazhdimësi marrin pjesë në të gjitha garat e mundëshme, jo vetëm në komunën e Gostivarit por edhe më gjërë. Nxënësit kanë bashkëpunim, dhe që rezulton me shpërblime të shumta. Garat do të organizohen me qëllim që nxënësit ta zhvillojnë shpirtin garues, të zhvillohet përpjekje për arritjen e vlerave më të mëdha në kulturë, art dhe sport. Nëpërmjet tyre zhvillohet dhe thellohet interesi i nxënësve dhe vendoset një mardhënie aktive ndaj mësimi, zgjërohen bazat programore, thellohen dhe pasurohen dituritë.

Nxënësit për gara do të përgaditen në orët e mësimi shtues dhe në aktiviteteve të lira të nxënësve. Arsimtarët do u japin ndihmë nxënësve gjatë zgjedhjes së literaturës dhe kontrollimit të diturive. Për zgjedhjen e nxënësve për gara duhet të organizohen gara në mes individëve në kuadër të klasës ose në mes ekipeve në nivel të klasës. Nxënësit e zgjedhur shkojnë në gara më të larta.

Plani për gara

- Garë shkollore në matematikë-Mars.
- Garë shkollore në Gjeografi, Histori.
- Arsim fizik dhe shëndetësor-aktivitete sportive për patronatin e shkollës.
- Konkurs nga arti figurativ për patronatin e shkollës.
- Ndihma e parë Maj/Qershor.
- Gara nga fizika-Prill/Maj.
- Gjuhë angleze-Prill.

Arsimtarët e mësimit të lëndëve mësimore sipas zgjedhjes së lirë do organizojnë dhe gara të tjera ndërmjet klasave sipas mundësive dhe arritjes së rezultateve..

PUNA HUMANITARE-SHOQËRORE

Qëllimi i futjes së nxënësve në punën prodhuese dhe punë tjera të dobishme shoqërore është që tek ta të zhvillohet dashuri dhe marrëdhënie pozitive ndaj punës në përgjithësi, më së shpeshti kryhen në mjedisin lokal . Organizohen aksione punuese të nxënësve për rregullimin e shkollës dhe oborrit të shkollës, nxënësit demonstrojnë ndihmë ndaj të rrezikuarve social dhe personave invalid dhe marrin pjesë në aktivitete të tjera më rëndësi më të madhe shoqërore dhe humanitare.

Puna shoqërore humanitare do kryhet në mjedisin lokal dhe do të drejtojnë gjer te aktivitetet që kanë rëndësi më të gjërë shoqërore humanitare Për atë qëllim do përgaditen programe për mbrojtje dhe ruajtje të natyrës dhe rrethinës,aksione punuese të nxënësve, shënime të ndryshme nga patronati gjer te festat sipas kalendarit,kur do kenë nevojë, nxënësit do e rregullojnë shkollën dhe oborrin,do u japin ndihmë nxënësve në mësim ose të rrezikuarëve social dhe personave invalid dhe të ngjajshme.

PLAN PËR PUNË TË DOBISHME SHOQËRORE DHE HUMANITARE TË NXËNËSVE

- Rregullimi i klasës dhe kateve,mirëmbajtja e higjienës në klasa,korridore dhe në oborrin e shkollës.

- Rregullimi i klasës dhe korridorit.
- Pjesëmarrje në aktivitet sipas Eko- programit
- Zbukurimi i klasës me rastin e vitit të ri.
- Pjesëmarrje në festën e vitit të ri dhe në panaire të tjera.
- Pastrimi i shkollës me rastin e ditës së ekologjisë
- Pjesëmarrje në çfaqje me rastin e festës së Patronatit

Persona përgjegjëse:Fetanete Adili, Floreta Bilalli dhe Mirlinda Muharemi

BASHKËPUNIMI ME PRINDËT,BASHKËSINË,PARTNERËT SOCIAL DHE QEVERINË LOKALE

Që të ekzistojnë efekte më të mëdha në procesin edukativo-arsimor e domosdoshme është komunikim më të madh me prindin.Prindi domosdo të dinë si përparon fëmiju i tij,si sillet në shkollë,çfarë ndryshimesh vërejnë arsimtarët dhe të tjera.Nga ana tjetër dhe kujdestari i klasës,sepse është prind i nxënësit në shkollë detyrimisht duhet të jet më shumë i informuar për nxënësin,gjendja e re familjare,kushtet për punë dhe rend të tjera segmente socio-ekonomike nga jeta.Kordinimi në mes tyre është i mundshëm nëpërmjet organizimeve të takimeve individua.Takimet individuale i thërret sipas nevojës udhëheqësi i klasës,pedagogu,ndihmës drejtori ose drejtori i shkollës.Të njëjtat mund të organizohen dhe sipas dëshirës së prindit me qëllim-bisedë te udhëheqësi i klasës,te arsimtari i lëndës,te pedagogu,psikologu ose kuadri udhëheqës dhe zbulimi i masës stimulative për efektet më të mëdha në punën edukativo-arsimore.

Takimet e organizuara të njohura si prindore i thërret kujdestari i klasës.Mbahen minimum nga dy në gjysmëvjetor ose më së paku katër gjatë vitit shkollor.Në takimet prindore prindët njoftohen me gjendjen aktuale në klasë dhe në shkollë,problemet që nxënësit i hasin në mësim,bëhet analiza e suksesit,rregullshmëria dhe diciplina,lajmërohet prindi për notimin e nxënësit,rregullshmërinë,diciplinën,ndërmarrja e masave pedagogjike.Jepen propozime dhe sugjerime të caktuara nga ana e prindëve për përmirsimin e suksesit,rregullshmërisë dhe

diciplinës. Takimet prindore janë publike, të hapura dhe të detyrueshme, gjersa në raste të veçanta mund të marrin edhe karakter tjetër. Sipas nevojës në të njëjtat takime mund të jetë i pranishëm edhe drejtori, Ndhmës drejtori, pedagogu, këshilli i prindëve.

PËRKRAHJA E NXËNËSVE

-Të arriturat e nxënësve

Shkolla jonë gjithmonë merr pjesë në gara të ndryshme komunale, regjionale dhe republikane. Rezultatet janë të dukshme në lëndën e matematikës, fizikës gj. angleze dhe aktiviteteve sportive. Dhe këtë vit është paraparë Program për pjesëmarrje në gara të ndryshme gjersa nga ana e udhëheqësisë së shkollës do sigurohen mjete financiare për përgaditje dhe realizim.

Shkolla do t'i ndjek të arriturat e nxënësve në më shumë lami nga procesi edukativo-arsimor. Shkolla do t'i ndjek të arriturat e nxënësve ndërmjet raporteve të të gjitha periudhave kualifikuese. Me tabelarë tregues të suksesit sipas lëndëve mësimore, sipas paraleleve sipas llojit dhe preardhjes sociale, posaçërisht e përgaditur nga secili arsimtar i lëndës, sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe nota mesatare nëpër paralelele në nivel të shkollës.

-Masat parandaluese

Stërvitja dhe edukimi i njerëzve të rinj janë karakteristika kryesore të institucionit shkollorë. Sistemi i punës në shkollën fillore bashkëkohore megjithatë në masë të madhe fokusohen përpjekjet e profesorëve në dhënien e diturisë, sesa në drejtimet e edukimit të vlerave dhe normave të sjelljes. Preventiva e problemeve, të lidhura me përdorimin e substancave psikoaktive (si “lloj shmangëje dhe sjellje”) është vendosur në kushtet në mangësitë sistematike të burimeve (financiare, kohore, njerzore). Gjatë zbatimit të programit preventiv të caktuar do mund të angazhohet secili nga grupet shkollorë-arsimtarët, udhëheqësia, këshilltari pedagogjik, nxënësit e të tjerët. Por askush nuk e sheh programin parandalues me përgjegjësi të plotë, karakteristike për rolin funksional në institucion. (PROGRAMI)

-Klima pozitive socio-emocionale

Që të sigurohen marrëdhënie të përshtatëshme socio-emocionale në klasë,dhe aktivitetet edukativo-arsimore të drejtohen kah zhvillimi optimal dhe të lidhjeve të ndjenjave emocionale të grupeve të lënduara të talentur,është e domosdoshme që të mirret parasysh karakteristikat e grupeve të lënduar të talentëve të nxënësve,siç është ndjeshmëria,intenziviteti I ndjenjave,perfeksionizmi dhe në raste të caktuara besueshmëria e individit.Ndjeshmëria morale te talentët shprehet në nënyrë të mundëshme komplekse dhe dallohet me intenzitet të posaçëm.

Ndjenjat e këtyre individëve janë shumë lehtë të lëndueshme,kanë të shprehur fortë ndjenjën për bashkëjetesë me ngjarjet,tregojnë ndjenja me nxënësit e tjerë dhe me moshatarët,mbrojtës tregohen ndaj të tjerëve dhe nda midist dhe shpesh bien në situatë të qajnë për sjelljen e ndokujt,veprim ose gjatë një ngjajre të caktuar që e përjetojnë si pikëllim të posaçëm,jo të drejtë,jot të ndershem,fyerës dhe të tj.Kanë fortë të shprehur ndjenjën për përgjegjësi morale.dhe plotësisht natyrshëm,në kushte normale,rradhiten në anën e të mirës,ndershmërisë,të drejtës,të bukurës dhe të tj.Me propozimin e udhëheqësve të paraleleve,profesorëve,shërbimi profesional,me bashkëpunim me prindët do përgaditet dhe do planifikohen përmbajtje të përshtatura për moshën,të statusit emocional dhe emotiv të statutit të grupeve të talentuara dhe të lënduara gjithashtu planifikohen edhe punëtori interaktive për prindët e nxënësve që janë të kyçur në këtë program,që realizohet nga ana e shërbimit profesinal në shkollë

KUJDESI PËR SHËNDETIN

Arsimi shëndetësor te fëmijë në shkollë do të jetë prioritet jo vetëm për shkak të shëndetit,por nga shikimi i por nga vet sistemi”që të mund fëmijë të mësojnë,duhet të jenë të shëndosh”Duke u nisur nga ky konstatim,mbrojtja dhe përparimi i shëndetit të nxënësve do jetë obligim I të gjithë të punësuarve në shkollë,për të gjithë nxënësit,dhe me punë të drejtëpërdrejtë me prindët. Qendra medicinale e ka si prioritet në programin e tyre shëndetin e fëmijve dhe rinisë dhe të bashkësisë më të gjërë me qëllim që të kultivohet pozitiviteti në jetesën tradicionale,gjithmonë duke e përmirësuar shëndetin duke zhvilluar programe progresive dhe aktivitete për arsimin shëndetësor dhe për përparimin e shëndetit.

Qëllimi i programit përkujdesje të shëndetit të nxënësve do jetë që ti liroj nxënësit dhe arsimtarët në shkollë të ndërmarin aksione për jetë më të shëndosh , mjedis të pastër ekologjik të shëndosh , dhe me atë nëpërmjet të përmisimit të diturive për shëndetin dhe përparimin e tij nëpërmjet ligjeratave , informative dhe aktivitete konkrete nga ana e personave profesional nga qendra e mjekësis , nëpërmjet orës së klasës , nëpërmjet orëve për sport dhe aktiviteteve sportive , nëpërmjet kontrollimeve stomatologjike , pjesmarja në aktivitete sportive dhe format të tjera për organizimin e mënyrës së jetesës siç janë skijimi , pushimet e verës dhe shëtitje në natyrë . Me gjithë kompleksitetit dhe rëndësin e shëndetit të fëmijëve veçanarisht rëndësi të madhe do jepet shëndetit mental dhe fizik të nxënësve nëpërmjet : higjienës personale , ushqimit dhe të ushqyerit . Mbrojtja nga smundjet ngjitëse , siguri dhe ndihma e parë , droga , alkoholi dhe thithja e cigares , ushtrime fizike , zhvillim për vetëbesim , vetrespektim , komunikim ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve dhe prindëve dhe mjedisit .

Detyrat kryesore të të gjitha këtyre aktiviteteve janë :

- Të zhvillohet dhe formohet vetëdija tek nxënësit të shëndetit si burim themelor i fatit të njeriut
- Të dallohet veprimi i dëmshëm të agencave të ndryshëm ndaj shëndetit të njeriut dhe të aftësohet për pjesmarrje aktive në luftën për përparimin e shëndetit ,
- Të zhvillohet vetëdija për lidhjen e punës intelektuale dhe manuale dhe rëndësinë e veprimit të tyre për mbrojtjen e shëndetit .

Në shkollën tonë përmbajtjet programore do i realizojnë arsimtarët , shërbimi pedagogjik dhe psikologjik.

Higjiena në shkollë

Në shkollën tonë ka mjaftueshëm të punsuar, puntor ndihmës në krahasim me sipërfaqen e objektit .Oborri i shkollës gjatë tërë vitit ishte i pastërt por sipërfaqet e gjelbërta mirbahen rregullisht .

Në shkollën tonë gjendja është e mirë. Nxënësit kujdesen për higjienën,por edhe të punësuarit,si dhe ekipi menaxhues që ka dhënë kushte të mira në tualete dhe vendosja e shportave në korridore dhe në oborrin shkollor.

Këtë vit do të punohet mjaft për mirëmbajtjen e higjienës jo vetëm në pjesën e mbrendëshme të shkollës por edhe ne vet oborrin e shkollës. Mirmbajtja e të gjitha hapësirave,pastrami dhe meremetimi i tualeteve,rregullimi i zyrës së arsimtarëve,ngjyrosja e rrethojës së shkollës, mbledhja e përditëshme e mbeturinave nga të punësuarit si dhe organizimi për mirëmbajtjen e midisit të pastër nga ana e udhëheqësve të klasave janë aktivitete tona që do i ndërmarrim këtë vit shkollor që të kemi midis të shëndetshëm dhe të pastër.Kontribut të dalluar për këtë qëllim do të ket edhe rendi shtëpiak që do implementohet gjatë vit shkollor.

KONTROLLA SISTEMATIKE

Fëmijët e moshës shkollore janë grup i veçantë popullues që karakterizohet me ndryshime intensive fizike, psikologjike dhe sociale, që i bën ekskluzivisht të lënduar të faktorëve të rrezikshëm të papërshtatshëm nga rrethina. Ndryshimet në drejtim të përfitimit të pavarësisë më të madhe e shoqëruar me mbështetjen kah eksperimentimi me stilet dhe aktivitetet e reja të jetës, formojnë rrezikshmëri të reja shëndetësore.

Të lidhura në rend të parë me sjelljen. Për këtë shkak detektimi në kohë i rreziqeve shëndetësore si dhe zhvillimit psiko-social duhet që të jetë prioritet për kujdesjen e fëmijve shkollor.

Metoda klasike për skrining të shëndetit të fëmijëve të shkollës janë kontrollimet sistematike, që kryhen të organizuara në institucionet publike shëndetësore nga ana e shërbimeve për mbrojtje shëndetësore preventive dhe mbrojtje preventive stomatologjike të fëmijve shkollor.

Qëllimi i kontrollimit sistematik është:

- Ndjekja e zhvillimit fizik dhe psikologjik
- Detekcioni i hershëm i problemmeve shëndetësore dhe trajtimi në kohë i tyre.
- Njohje të hershme të llojeve të sjelljeve të rrezikshme-detektimi i rreziqeve bihejviorale.
- Edukim për përvetësimin të stileve të shëndosha jetësore.
- Edukimi dhe rëndësia e të vaksinuarit të plotë dhe në kohë.

Nxënësit e shkollës së fillore janë të përfshirë në kontrollimin sistematik sipas orarit të paraparë nga ana e institucionit shëndetësor që shpallet në tabelën e shpalljeve.

Përmbajtja e kontrollimit sistematik:

1. Vizitë e përgjithëshme mjeksore
2. Pasqyrë laboratorike,
3. Vizitë stomatologjike.

Bartës: Udhëheqësit e klasave

VAKSINIMI

Nxënësit duhet të vaksinohen që organizmi i tyre të marrë imunitet të disa sëmurjeve të rënda ngjitëse. Vaksina është më e dobët që të nxitë sëmundje, por megjithatë e nxitë trupin të prodhojë antitropa që në të ardhmen do ta mbrojnë ata nga sëmundjet.

Kalendar për vaksinim		
Mosha e fëmijevë që i nënshtrohen imunizimi	Sëmundja kundër të cilit kryhet imunizimi	Vaksinimi/ Rivaksinimi

Përgjegjës: Qendra medicinale, udhëheqësit e klasave dhe arsimtarët.

-Edukim për ushqim të shëndetshëm

Për ushqim të shëndetshëm do organizojnë në shkollën tonë projekt edukues që të njoftohen nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e shkollës sonë për rëndësinë e ushqimit të shëndosh. Qëllimi i realizimit të projektit të përbashkët, është rritja e vetëdijes të popullatës dhe re për ndërtimin dhe praktikimin e shprehive të shëndosha në ushqim, zhvillim dhe nxitje e krijueshmërisë, por edhe në të njëjtën kohë dhe të japim përkrahje për ditën e Shëndetësisë, si iniciativë globale për ndërtimin e gjeneratave të shëndosha.

Në kuadër të ditës së shëndetit, gjithashtu nxënësit e klasës së teta dhe të nënta nëpërmjet lojërave, vizatimeve dhe ligjëratave nxënësve të gjeneratave më të reja do u paraqesin rëndësinë e ushqimit të shëndosh.

KLIMA DHE MARRËDHËNJET NË SHKOLLË

Klima shkollore paraqet atmosferë shoqërore në të cilën njerëzit vijnë në interaksion me të tjerët si dhe me rrethin shkollore. Klima shkollore vë në veprim perceptimin të cilën njerëzit e kanë për aspekte të ndryshme në rrethin e brendshëm. Dhe më shumë nga ajo, klima shkollore vë në veprim aspekte që ndikojnë te sjellja e njerëzve te sjelljet e tyre ndërmjet vedi.

Shkolla jonë ka klimë pozitive shkollore e cila karakterizohet me kohezivitet grupor dhe solidaritete ndërmjet nxënësve, arsimtarëve, por edhe me respektim të ndërsjellë ndërmjet nxënësit dhe arsimtarit, me mundësi që nxënësit t'i tregojnë mendimet e tyre, në mënyrë aktive të marrin pjesë në punën e orës mësimore, si dhe me ndjenjën e përkatësisë në shkollë. Që të ndërtohet një klimë e tillë pozitive, kontribut jep edhe drejtori i shkollës i cili posedon karakteristikat përkatëse të sjelljes. Mirëpo edhe përkundër ndikimit të drejtorit, në formimin e klimës, në masë të madhe marrin pjesë dhe arsimtarët dhe nxënësit me qëndrimet e tyre dhe sjelljes si në shkollë ashtu edhe jashtë saj.

DISIPLINA

Disiplina dhe rendi te nxënësit në shkollë është më se e nevojshme nëse duam të gjithë atë që e kemi planifikuar ti realizojmë. Me fjalë të tjera, duke u mbështetur në kuptimin tradicional dhe shkollën tradicionale qëndrimet e të gjithë të punësuarve në shkollën tonë është se nxënësit janë të dëgjueshëm dhe të dicitlinuar edhe pse kjo nuk korrespondon me realitetin, sepse që të kesh nxënë të urtë në klasë nuk dmth se ka edhe nxënë të dicitlinuar. Përafërsisht të gjithë pajtohen se mënyra e mirë e mësimi nga ana e arsimtarit është themel për vendosjen e dicitlinës në orë. Por, nxënësit megjithatë në momente do jenë të padëgjueshëm edhe te arsimtari më me përvojë dhe ky problem medoemos të zgjidhet.

Kur arsimtarët flasin për mosdicitlinën e nxënësve, duhet të kemi parasysh standardet se çka është jodisiplina dhe që kjo ndryshon prej arsimtari në arsimtar. Ndonjë arsimtar mund të kërkon qetësi të plotë gjatë kohës së orës mësimore kur nxënësit punojnë, gjersa ndonjë tjetër e lejon zhurmmën. Disa nxënës janë të qetë gjersa arsimtari hyn në klasë gjersa të tjerët mezi presin që të del arsimtari nga klasa dhe të bërtasin.

Preventivat për jodisciplinën nga arsimtar me përvojë në orën mësimore janë:

- Lëviz shpesh nëpër klasë dhe i pyet nxënësit si ia kalojnë,
- Kohë pas kohe me shiqim përshkoj tërë klasën, dhe nëse ndonjë nxënë është i padisciplinuar individualisht më afër ia tërheq vërejtjen,

- Nxënësi që flet pa u vërejtur i afrohet,
 - Barabarësisht i kyçen të gjithë nxënësit në aktivitetin e orës.
 - Kur punon frontalisht kohë pas kohe ndonjë nxënës do të shikon në sy,jo më gjatë dhe veçmas te nxënësit e padisciplionuar.
 - Shpesh u ndihmon dhe i nxitë për punë nxënësit.,
 - Shpesh i ndryshon aktivitetet dhe dinamikën e punës gjatë orës,
 - Gjatë jodisciplinës së përhershme detyrimisht e regjistron dhe jep vërejtje,
 - Shpesh ua ndron vendet nxënësve që të ik nga nxënësit e padisciplinuar.
- Përgjegjës:Arsimtarët kujdestar,ndihmës drejtori,shëbimi profesional,arsimtarët.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I KUDRIT ARSIMOR

Në këtë pjesë i paraqesim të gjitha programet përcaktuese të cila kontribuojnë për zhvillimin profesional dhe përsosjen profesionale të bashkëpunëtorëve profesional dhe arsimtarëve.Përveç tyre, marrim pjesë aktive në të gjitha seminarët të organizuar nga Mash-ës seminare të organizuara brenda shkollës dhe në punëtori educative,të organizuara nga Zyra për zhvillimin e arsimit,USAID ose organizata tjera joqeveritare dhe organizata të tjera të akredituara në vendin tonë.

Qëllimet dhe detyrat:Motivimi i arsimtarëve vazhdimësin e zhvillimit profesional për punë të suksesshme dhe efikase.Arsimtari gjithonë t'I zhvillon kompetencat e veta me qëllim që të arrin dhe të mban kualitet të lartë në mësim në pajtim me trendet bashkëkohore dhe me kërkesat e botës bashkohore.

10 Aktivitetet per realizimin e qellimeve

Programet e aktiviteve te palnifikuara	Koha e realizimit	realizues	Gjithë grupa	Rezultatet e pritura dhe efektet
1	2	3	4	5
Njoftimi i programit vjetor të punës për zhvillimin profesional të mësimeve të mësuesve Ndarja e profesorëve në epike për punë	Shtator	Rabi Ismaili Ferdane Velija Lindihana Ebibi	Për të gjithë profesorët,	Planifikimi dhe organizimi i aktiviteve të parashikuara në programin vjetor
Puntori mbi ekipet	Dhjetor , shkurt , mars	Rabi Ismaili Ferdane Velija Lindihana Ebibi	Për të gjithë profesorët,	Realizimi I aktiviteve të planifikuara me programin vjetor
Prezantimi i materialit të përgaditur	april	Rabi Ismaili Ferdane Velija Lindihana Ebibi	Për të gjithë profesorët,	Zbatimi i aktiviteve të planifikuara me programin vjetor

Përgjegjës : Rabi Ismaili- ndihmës drejtor

Portfolio e arsimtarëve

Qëllmi : Motivimi i nxënësve për zhvillim të vazhdueshëm professional kusht për punë efikase dhe të sukseshme
Aktivitete për realizime qëllimeve

Programet e aktiviteteve të palnifikuara	Koha e realizimit	realizues	Gjithë grupa	Rezultatet e pritura dhe efektet
1	2	3	4	5
Organizimi i koleksionit i të dhënave për portogfolion e profesorëve	Kontinuitet	mësimdhënës	Profesorët e lëndëve	Kontribut I më tej për organizimin e një portofol të mësimdhënies
Vlerësimi i të dhënave në një portofol të mësimdhënies	Gjatë vitit shkollor	Mësimdhënës përgjegjës	Profesorët e lëndëve	Vendosja e marrëdhënieve në mes të qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies
Paraqitja e raportit të vlerësimit	Në fund të gjysëmvetorit të parë dhe të dytë	Mësimdhënës përgjegjës	Profesorët e lëndëve	Fizibiliteti i qëllimeve dhe objektivave

Përgjegjës: Rabi Ismaili, Ferdane Velija

II.PËRFSHIRJA E FAMILJES NË SHKOLLË

- Për jetën dhe punën e shkollës

Bashkëpunimi ndërmjet SHFK “ Naim Frashëri” dhe familjes është shumë e rëndësishme për arritjen e punës arsimore dhe fillon nga premise që familja luan rolin kryesor në jetën e fëmiut. Njohja me karakteristikat themelore të familjes (Sociale, kulturore, ekonomike, statusi arsimor kontribon për zhvillim të bashkëpunimit në mënyrë që I përgjigjet familjes dhe ndihmon që të arrihen qëllimet e procesit arsimor.

Principet themelore të bashkëpunimit me familjen në bazë të kujdesit të partneritetit, respektimit të personave dhe roli I prindërve, të spektrit më të gjerë të mundësive për kyçjen e prindërve, respektimi I ideve të prindërve, idea e bashkëpunimit si proces kërkon kohë, durim dhe ndarje të përgjegjësisë, profesionale në raport me informatat e fituara nga prindët, respektimi I privatësisë së familjes dhe të tjera.

Format për bashkëpunim me familjen;

-Komunikimi I drejtëpërdrejt ndërmjet arsimtarëve dhe prindëve-vizitë shkollës, bisedohet për rendin shtëpiak të shkollës, intervista individuale.

- Komunikim me shkrim-bilborde,vende për prindë,kumtesa,broshura,portofolje,kompjutera individual të bartshëm;
- Pjesëmarrja e prindëve në punën me fëmijvenë konsultim me arsimtarët të jenë të kyçur në kryerjen e disa aktiviteteve dhe të bëhen njëherit edhe bashkëpunëtor të arsimtarëve për kryerjen e aktiviteteve si dhe pjesëmarrja e tyre në ngjarje dhe ndodhi të ndryshme.
- Mbledhje-me qëllim të përfshihen prindët në jetën dhe punën e shkollës,në raport me temën dhe mësimin,arsimimin e fëmiut.
- Lloj i posaçëm për përfshirjen e prindit në jetën dhe punën e shkollës- institucionit është Këshilli I prindëve.

12.KOMUNIKIMI ME OPINIONIN DHE PROMOVIMI I SHKOLLËS

- *Bashkësia lokale*

*Shkolla do të ketë ekskluzivisht bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale(Komuna eVrapçishtit) si themelues,poaçërisht me sektorin e arsimit. Do të mbahen mbledhje ku do të ndihmohet gjatë përgaditjes dhe realizimit të programit për punë,gjithashtu do të mbahen mbledhje të ndryshme për raste të caktuara etj. Prej këshillit të komunës së Vrapçishtit kemi dy anëtarë në Këshillin e shkollës. Do insistoahet të nënshkruhet Memorandum për bashkëpunim në nivel lokal për realizimin e programeve të përbashkëta ekologjike.

*për çdo aksion nga të gjitha sferat e mundëshme të organizuara nga ana e bashkësive vendore,shkolla jonë me nxënës dhe arsimtar gjithmon do të jetë mbrojtëse(patron)kryesor,sidomos në pjesën e fatëkeqësive natyrore(vërshimeve)dhe në pjesën e ekologjisë.

- *Institucionet nga lëmia e kulturës*

Nga fillimi planifikohet që të ndiqen të gjitha konkurset e shpallura dhe garat e organizuara. Gjithmonë profesorët nga lëndët e gjuhës amtare do ta marrin pjesë në konkurse të ndryshme letrare ndërsa profesorët e artit do marín pjesë në konkurset e artit. vendet e fituara do të jenë të shpallur nxënësit së bashku me mentorët e tyre nga ana e shkollës. Nga fillimii vitit shkollor profesorët përgjegjës me nxënësit do ti vitizojnë dhe

do ti organizojnë ekspozita të ndryshme,panaire për libra, vizita e përmendoreve kulturore dhe historike në data të caktuara , muzeemeve , shfaqjeve të ndryshme letrare etj.

- *Institucionet nga lëmia e arsimit*

Bashkëpunimi me MASH, BZHA dhe me sektorin e arsimit fillor do insistojmë që të jet në nivel. Gjithmonë do ju përgjigjena detyrave të dhëna nga pjesa e veprimtarisë edukativo-arsimore dhe statistikës.Gjithmonë inspektorët dhe këshilltarët me dashamirësi do priten dhe do u mundësojmë që pa pengesa ta kryejnë detyrën e tyre.

- *Organizatrat qeveritare*

Nxënësit do marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme proektuese në shkollë dhe në realizimin e programeve të zgjëruara gjatë bashkëpunimit në veprimtarisë kulturore publike të komunës,përkrahje të aktiviteteve proekjtuese në bashkëpunim me organizatat joqeveritare qytetare,pjesëmarrje në ekspozita me eksponante nga puna dhe aktivitetet nga Eko- program

-*Organizatrat shëndetësore*

Për kujdesin ndaj shëndetit dhe sigurisë së nxënësve dhe punëtorëve shkolla jonë ka një bashkëpunim të mirë me Shtëpinë e Shëndetit në Gostivar.

-*Mediumet*

Ne jemi të hapur dhe shkollë transparente ndaj publikut.Këtu jemi që tu përgjigjena për të gjitha dobësitë tona por edhe për rezultatet e mira nga procesi edukativo-arsimor.Bashkëpunimi gjithmonë do të jet në nivel solid me mediumet e shkruara dhe ato elektronike siç janë GLOB,TV KOHA, ALSAT,MTV, dhe të tjera dhe me mjetet e shtypit NOVA MAKEDONIJA,VEÇER,DNEVNIK,ZHURNAL,KOHA,LAJM dhe të tjera.Shkolla ka edhe web faqen e vet. Gjithashtu do formohet ekip- person për kontakt me mediumet, ndihmës drejtori Rabi Ismaili që do ket detyrë të formon ekip dhe të organizon ndodhi dhe aktivitete nga programi ekologjik dhe promovimi i tyre para medimeve dhe publikut-fletushka shkollore.

**Ekipi që morri pjesë në përgatitjen e programit: Bejtulla Kamberi,Rabi Ismaili, Lindihana Ebibi dhe mësimdhënësit tjerë nëpërmjet ideve dhe sugjerimeve për përpilimin e programës.*

- *Vendi për vullë*

- *Data dhe nënshkrimi i drejtorit*
- *Nënshkrimi i kryetarit të KSH*